



Pranuar / Dorezuar Pritjenor/Prishtar Received/Delivered	14-06-2021	1	viti god year
Organ /Njësia Organ/Jednitca Org /Unit	Nr Prot Nr Prot	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKM/SHUK	3048/2021		1/4



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.510/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Jeton Koca-kryetar, Eshref Shabani dhe Malsore Gashi-Bajraktari-anëtarë, me Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, bazuar në Aktgjykimin A.nr.3079/19 të datës 11.03.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.287/2019 të datës 17.05.2019 të parashtruar nga ankuesja

nga Prishtina, të cilën me autorizim e përfaqëson Avokatja me adresë Rr. "Tringë Smajli", kati I, banesa nr.4, në Prishtinë, kundër Vendimit me Nr.17/2019 të datës 30.04.2019 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Ministrisë së Punëve të Brendshme, në çështjen juridike "*kompensim material*", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datë 14.06.2021, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pa bazuar ankesa me numër A.nr.287/2019 e datës 17.05.2019 e parashtruar nga ankuesja

II.Mbetet në fuqi Vendimi me Nr.17/2019 i datës 30.04.2019 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Ministrisë së Punëve të Brendshme.

A r s y e t i m

Ankueses e punësuar në pozitën e punës Nëpunëse Administrative në Agjencinë e Regjistrimit Civil pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme, me datë 17.05.2019 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 2355/2019 të regjistruar me numër A.nr.287/2019 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Nr.17/2019 i datës 30.04.2019 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të

Ministrisë së Punëve të Brendshme, përmes të cilit i është refuzuar ankesa si e pa bazuar lidhur me kompensimin e dy pagave jubilarë dhe dy pagave përcjellës me rastin e pensionimit, sipas Kontratës së Përgjithshme Kolektive të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat ligjore në fuqi, ankesën e ankuesit e ka proceduar për përgjigje në ankesë të Ministria e Punëve të Brendshme. Këshilli, me datë 13.06.2019 ka pranuar përgjigje në ankesë se bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në mungesë të kuorumit për vendosje ka udhëzuar ankuesen për ushtrimin e mjeteve juridike në gjykatë sipas dispozitave të Ligjit për Konfliktin Administrativ. Gjykata Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, me datë 11.03.2021 ka nxjerr Aktgjykim A.nr.3079/19 përmes të cilit ka detyruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, që të shqyrtojë dhe të vendos për ankesën e datës 17.05.2019 të parashtruar nga ankuesja

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokollit 2355/2019 të regjistruar me numër A.nr.287/2019 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me Nr.17/2019 të datës 30.04.2019 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Ministrisë së Punëve të Brendshme; Vendimin me Nr.02-1425 të datës 07.03.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Regjistrimit Civil; Listën e pagave të muajit mars 2019; Kërkesën e datës 03.04.2019 nga ankuesja; Njoftimin e datës 03.09.2018 për ndërprerjen e marrëdhënies së punës për shkak të pensionimit dhe përgjigjen në ankesë të datës 13.06.2019 me numër protokollit 2682/2019; Njoftimin e datës 21.08.2019 për ankuesen; Kërkesën e datës 20.11.2019; Përgjigjen në kërkesë të datës 25.11.2019; dhe Aktgjykimin A.nr.3079/19 të datës 11.03.2019 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës të dërguara nga ankuesi dhe organi i punësimit, ka konstatuar se ankesa e ankueses ***është e pa bazuar, sepse:***

Bazuar në shkresat e lëndës është konstatuar se ankuesja ka qenë e punësuar në pozitën e punës Nëpunëse Administrative në Agjencinë e Regjistrimit Civil pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme, deri në ditën e pensionimit, me datë 03.03.2019. Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së Regjistrimit Civil, me datë 04.03.2019 ka nxjerr Vendimin me numër protokollit 02-1425 përmes të cilit ankueses i është përfunduar marrëdhënia e punës për shkak të pensionimit dhe të njëjtës i është njohur e drejta e realizimi të një page përcjellëse në vlerën e pagës së fundit.

Kundër Vendimit me Nr.02-1425 të datës 04.03.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Regjistrimit Civil, ankuesja me datë 03.04.2019 ka parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Ministrisë së Punëve të Brendshme, me pretendimin ankimor për kompensimin dy pagave jubilarë dhe dy pagave përcjellës me rastin e pensionimit.

Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave, me datë 30.04.2019 ka nxjerr Vendim me Nr.17/2019 përmes të cilin ka refuzuar si të pa bazuar ankesën e ankueses dhe ka lënë në fuqi Vendimin me Nr.02-1425 të datës 04.03.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Regjistrimit Civil.

Ankuesja në ankesën e parashtruar me datë 17.05.2019 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës, pretendon realizimin e dy pagave jubilarë dhe dy pagave përcjellës me rastin e pensionimit, sipas Kontratës së Përgjithshme Kolektive të Kosovës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka shqyrtuar bazën ligjore mbi të cilën janë ngritur pretendimet ankimore të ankueses, dhe si rrjedhojë ka konstatuar se Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e Kosovës, e publikuar në Gazetën Zyrtare Nr.38/2014 të datës 18.06.2014, ka hyrë në fuqi me datë 01.01.2015 dhe e njëjta sipas nenit 90 paragrafi 4 të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës, ka qenë e zbatueshme në periudhë jo me shume se tri (3) vjet, respektivisht deri me datë 31.12.2017. Kolegji po ashtu ka konstatuar se Oda Ekonomike e Kosovës si Partner i barabartë në Këshillin Ekonomiko Social, dhe njeherit nënshkruese e Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës, me datë 15.09.2017 është tërhequr nga zbatimi i Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës, dhe rrjedhimisht ka pamundësuar zbatimin e Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive, pas datës 31.12.2017, kështu që pretendimi ankimor i ankueses për realizimin e kompensimit të dy pagave jubilarë dhe dy pagave përcjellës me rastin e pensionimit, mbi këtë bazë ligjore, është i pa bazuar, sepse ankuesja ka arritur moshën e pensionimit me datë 03.03.2019 në kohën kur nuk ka qenë e aplikueshme Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e Kosovës.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, bazuar në konstatimin si me lartë vlerëson se Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së Regjistrimit Civil, me rastin e nxjerrjes së Vendimit me numër protokollit 02-1425 të datës 04.03.2019 përmes të cilit ankueses me rastin e pensionimit ia ka njohur të drejta e kompensimit të një page përcjellëse në vlerën e pagës së fundit, ka vepruar në pajtim me dispozitat e nenit 22 paragrafi 2 nën paragrafi 2.2 të Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë, si dhe dispozitat e Rregullores Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të tjera të Nëpunësve Civilë, përkatësisht nenin 19 paragrafi 2 ku përcaktohet se: *Nëpunësi civil, që arrin moshën e pensionimit, gëzon të drejtën e marrjes së një pagese në shumën prej një (1) page mujore të njëhershme në vlerën e pagës së fundit.* Kolegji po ashtu konstaton se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme, me rastin e nxjerrjes së Vendimit me Nr.17/2019 të datës 02.05.2019 përmes të cilit ka refuzuar ankesën e ankueses si të pa bazuar, ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe bazën juridike, duke vepruar kështu në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, dhe Rregulloren Nr.05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe Ankesave.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nën 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe neni 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031

për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.510/2021

Avdyll BEKTESHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



Jeton KOCA
Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Përfaqësuesit të autorizuar të ankueses Avokate
- Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Regjistrimit Civil;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Punëve të Brendshme; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

